



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.60

26 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.264, datë 7.4.2010	Për krijimin e bordeve të kullimit në zonat e shërbimit të kullimit Tiranë-Kavajë, Korçë-Pogradec e Vlorë-Sarandë, si dhe për një shtesë në vendimin nr.286, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit”..... 2271
Vendim i KM nr.278, datë 28.4.2010	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2010, për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 2274
Vendim i KM nr.279, datë 7.4.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.23, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare Bërthamore”..... 2275
Vendim i KM nr.280, datë 28.4.2010	Për një shtesë fondi për Komisionin e Prokurimit Publik..... 2276
Vendim i KM nr.282, datë 21.4.2010	Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për programin mbështetës (AlbVET) për arsimin dhe trajnimin profesional shqiptar (ATP), faza II, korrik 2009-qershor 2011..... 2277
Vendim i KM nr.283, datë 21.4.2010	Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për edukimin alternativ dhe trajnimin profesional (CEFA), faza e gjashtë, maj 2009-qershor 2012..... 2282

Vendim i KM nr.284, datë 21.4.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe në atë të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi.....	2286
Vendim i KM nr.285, datë 28.4.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në histori, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh.....	2287
Vendim i KM nr.286, datë 28.4.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në gjeografi, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh.....	2288
Vendim i KM nr.287, datë 28.4.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private “Kristal”, Tiranë.....	2289
Vendim i KM nr.292, datë 28.4.2010	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Beratit.....	2290
Vendim i KM nr.301, datë 13.4.2010	Për një shtesë në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar.....	2290
Vendim i KM nr.302, datë 28.4.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rragam-Kam-Tropojë.....	2291
Vendim i KM nr.303, datë 28.4.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për ndërtimin me koncesion të terminalit të konteinerëve, në portin e Durrësit, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë “Durrës Kurum Shipping” sh.a.....	2293
Vendim i KM nr.304, datë 28.4.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Ëngjëll Gjondrekaj, në Itali.....	2293
Kërkesë e MPPT nr.2816, datë 11.5.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore Korçë (Dritat e Verdha, kryqëzimi Korçë-Kapshticë)”	2294

VENDIM
Nr.264, datë 7.4.2010

**PËR KRIJIMIN E BORDEVE TË KULLIMIT NË ZONAT E SHËRBIMIT TË KULLIMIT
TIRANË-KAVAJË, KORÇË-POGRADEC E VLORË-SARANDË, SI DHE PËR NJË SHITESË
NË VENDIMIN NR.286, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT
TË ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordeve të kullimit në zonat e shërbimit të kullimit Tiranë-Kavajë, Korçë-Pogradec dhe Vlorë-Sarandë, të financuara nga Buxheti i Shtetit.

2. Zonat e shërbimit të kullimit të këtyre bordeve të jenë, përkatësisht, sipas lidhjeve 1, 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Këshillat e përfaqësuesve të bordeve të kullimit Tiranë-Kavajë, Korçë-Pogradec dhe Vlorë-Sarandë të kenë në përbërje nga:

a) 1 (një) përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) 2 (dy) përfaqësues të federatave dhe organizatave të përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 2(dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 1(një) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1(një) përfaqësues të këshillit të qarkut.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen me 5 000 (pesë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

6. Pas shkronjës “h” të pikës 2 të vendimit nr.286, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit”, të shtohen shkronjat “i”, “j” dhe “k”, me këtë përmbajtje:

“i) Zona e fushës së Peqinit (PEK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 820 (tetëqind e njëzet) ha.

j) Zona e fushës Darsi Vashaj (PEK-2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1 045 (një mijë e dyzet e pesë) ha.

k) Zona e fushës së Bishqemit (PEK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 50 (pesëdhjetë) ha.”.

7. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.279, datë 16.4.2004 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Tiranës”, nr.490, datë 16.10.2002 “Për krijimin e bordit të kullimit të rrethit të Kavajës”, nr.281, datë 16.4.2004 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Korçës”, nr.64, datë 28.1.2005 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Pogradecit”, nr.289, datë 16.4.2004 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Vlorës”, dhe nr.65, datë 28.1.2005 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Sarandës”, shfuqizohen.

8. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
2271

ZONA E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË BORDIT TË KULLIMIT TIRANË-KAVAJË

1. Zona e fushës Kamëz-Zallher (TRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1475 ha.
2. Zona e fushës Paskuqan-Kashar-Prezë dhe Gjokaj-Vorë-Marikaj (TRK-6,17), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2900 ha.
3. Zona e fushës Petrelë-Arbanë-Stërmas (TRK-20), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1050 ha.
4. Zona e fushës së Baldushkut (TRK-21), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 430 ha.
5. Zona e fushës së lumit Erzen (TRK-26,29,32,39), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1014 ha.
6. Zona e fushës Bërzhidë-Fikas (TRK-47,48), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 225 ha.
7. Zona e fushës së Kavajës, që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 8030 ha.
8. Zona kodrinore Okshun-Golem, që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2060 ha.
9. Zona që kullohet nga hidrovori i Synejit, me sipërfaqe 500 ha.
10. Zona që kullohet nga hidrovori i Rreth-Grethit, me sipërfaqe 460 ha.
11. Pendët/argjinaturat mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve, bregdetare dhe të kanaleve të ujërave të larta.
12. Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

ZONA E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË BORDIT TË KULLIMIT KORÇË-POGRADEÇ

1. Zona e fushës Korçë-Dvoran-Qafë-Qarr (KOK1/1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 5400 ha.
2. Zona e fushës Diga Zemblak-Maliq (KOK1/2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 9330 ha.
3. Zona e fushës Pirg-qyteti Maliq (KOK1/3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2870 ha.
4. Zona e fushës së Maliqit (KOK-2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 5300 ha.
5. Zona e fushës Makers-Lubonjë (KOK-3, KOK-4), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 282 ha.
6. Zona e fushës Liqenas-Goricë (KOK-5, KOK-6), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 333 ha.
7. Zona e fushës Cangonj-Progër-Vranisht-Tren (DVK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2339 ha.
8. Zona e fushës Hoçisht-Vërlen-Vishocicë (DVK-2, DVK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 993 ha.
9. Zona e fushës Qendër-Qytet (ERQ), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 360 ha.
10. Zona e fushës Makërz-Çlirim-Boshanj-Vodicë (ERC-1, ERM-1,2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 101 ha.
11. Zona e fushës Kagjinë-Barmash-Sudenicë-Leskovic-Ymelinë-Radanjë (ERP-1,2, ERL-1,2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 270 ha.
12. Zona e fushës së Starovës, me sipërfaqe 800 ha, nga të cilat 300 ha kullojnë me ngritje mekanike, me hidrovore dhe 500 ha kullon me rrjedhje të lirë.
13. Zona e fushës së Leshnicës-Stropckës, që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 300 ha.
14. Zona e fushës së Çërravës, që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 200 ha.

15. Zona e fushës së Petrushës, që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 250 ha.
16. Zona e fushave pranë liqenit të Ohrit (Lin-Hudenisht), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 300 ha.
17. Pendët/argjinaturat mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta.
18. Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

Lidhja nr.3

ZONA E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË BORDIT TË KULLIMIT VLORË-SARANDË

1. Zona e fushës së Myzeqesë (VLK-1,2,3), që kullon 6650 ha, nga të cilat me ngritje mekanike me hidrovor 5550 ha dhe me rrjedhje të lirë 1100 ha.
2. Zona e fushës Llakatund-Armen (VLK-4,5), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2800 ha.
3. Zona e fushës Dukat-Tragjas (VLK-6), që kullon 1800 ha, nga të cilat me ngritje mekanike me hidrovor 400 ha dhe me rrjedhje të lirë 1400 ha.
4. Zona e fushës së lumit Shushicë nga Drashovica deri në Kallarë (VLK-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 4010 ha.
5. Zona e fushës Sevaster-Shkozë-Dushkarat-Karbanarë-Romes (VLK-8), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1000 ha.
6. Zona e fushës së Petes. Harvalasë, Peshkëpi-Vllahisë, Trevllazër-Cergovisë (VLK-9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1750 ha.
7. Zona e fushës së Bregut, Qeparo-Himarë-Vuno-Pilur (VLK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 420 ha.
8. Zona e fushës së Pavlit (SRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1332 ha.
9. Zona e fushës Konispol-Zare (SRK-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 5000 ha.
10. Zona e fushës së Vurgut (SRK-2,DLK-1), që kullon 3643 ha, nga të cilat me ngritje mekanike me hidrovor 900 ha dhe me rrjedhje të lirë 2743 ha.
11. Zona e fushës së Vagalatit (SRK-3, SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1585 ha.
12. Zona e fushës së Gravës (SRK-4), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 348 ha.
13. Zona e fushës së Butrintit (SRK-6), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor, me sipërfaqe 800 ha.
14. Zona e fushës së Borshit (SRK-8), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 130 ha.
15. Zona e fushës së Volloderit (SRK-9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 160 ha.
16. Zona e fushës së Navaricës (SRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 250 ha.
17. Zona e fushës së Vurgut, Delvinë (DLK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 2743 ha.
18. Zona e fushës Stjar-Mesopotam (DLK-2), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 200 ha.
19. Zona e fushës së Vergo-Kalasë (DLK-3), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 400 ha.
20. Pendët/argjinaturat mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve, bregdetare dhe të kanaleve të ujërave të larta, si dhe argjinaturën kufizuese të liqenit të Nartës.
21. Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

VENDIM
Nr.278, datë 28.4.2010

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT 2010, PËR BASHKËSITË FETARE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Buxheti prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh, i miratuar për financimin e bashkësive fetare, për vitin 2010, të përdoret sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, e sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë, të ndarë:

i) 18 360 000 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 9 640 000 (nëntë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë, për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në Durrës, Has, Kolonjë, Tropojë-Degë etj.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 22 680 000 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 3 348 000 (tre milionë e treqind e dyzet e tetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 20 652 000 (njëzet milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin për pagat e arsimtarëve të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, të ndarë:

i) 4 320 000 (katër milionë e treqind e njëzet mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore, për punonjësit e administratës;

ii) 12 680 000 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për ndërtimin e për mirëmbajtjen e objekteve të kultit “Odeoni”;

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

I. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me shumën prej 28 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 18 360 000 lekësh, për 170 punonjës.

2. Për rikonstrukcion dhe mirëmbajtjen e objekteve të kultit në shumën prej 9 640 000 lekë për objektet e mëposhtme:

a)	Xhamia Krumë, Has	2 836 890 lekë
b)	Xhamia Selishtë	2 022 510 lekë
c)	Xhamia Fatih, Durrës	1 623 491 lekë
d)	Xhamia Ishëm, Durrës	1 617 000 lekë
e)	Xhamia Degë, Tropojë	1 540 109 lekë.

II. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 22 680 000 lekësh për 210 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën prej 1 320 000 lekësh, për 12 punonjës.

III. Kisha Katolike me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 3 348 000 lekësh për 31 punonjës.

2. Mbështetje për pagat e arsimtarëve në shumën prej 20 652 000 lekësh, për 191 punonjës.

IV. Kryegjyshata Botërore Bektashiane me shumën prej 24 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

1. Mbështetje për fondin e pagave të personelit në shumën prej 4 320 000 lekësh për 40 punonjës.

2. Për rikonstrukcion e mirëmbajtje të objekteve të kultit në shumën prej 12 680 000 lekësh, për objektin “Odeon”.

3. Për Kryegjyshitën Botërore si kryeqendër, për veprimtari ndërkombëtare, në shumën prej 7 000 000 lekësh të ndarë si më poshtë:

a)	Veprimtaria ndërkombëtare për 800 vjetorin e H. Bektash Veliut	1 850 000 ekë
b)	Kongresi Botëror i Bektashinjve	4 000 000 lekë
c)	Për udhëtime e pritje të Kryegjyshit shumën prej	1 150 000 lekësh.

VENDIM

Nr.279, datë 7.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.23, DATË 20.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE BËRTHAMORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.23, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “...në varësi të Kryeministrit...” zëvendësohen me “...në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

2. Në pikën 7 fjalët "... me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin..." zëvendësohen me "...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..."

3. Në pikën 8 fjalët "...me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin..." zëvendësohen me "...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..."

4. Në pikën 9 fjalët "...me propozimin e sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave..." zëvendësohen me "...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..."

5. Në pikën 10 fjalët "... Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin..." zëvendësohen me "... Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.280, datë 28.4.2010

PËR NJË SHITESË FONDI PËR KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit të Prokurimit Publik, në buxhetin e vitit 2010, në programin "Shërbimi i prokurimit publik", të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave (grupi 87) i shtohet fondi prej 29 405 000 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e pesë mijë) lekësh, përkatësisht, 21 405 000 (njëzet e një milionë e katërqind e pesë mijë) lekë për shpenzime korrente dhe 8 000 000 (tetë milionë) lekë për shpenzime kapitale.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.282, datë 21.4.2010

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
SË ZVICRËS, PËR PROGRAMIN MBËSHTETËS (ALBVET) PËR ARSIMIN DHE
TRAJNIMIN PROFESIONAL SHQIPTAR (ATP), FAZA II, KORRIK 2009-QERSHOR 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për programin mbështetës (AlbVET) për arsimin dhe trajnimin profesional shqiptar (ATP), faza II, korrik 2009-qershor 2011.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE MBI PROGRAMIN MBËSHTETËS (AlbVET)
PËR ARSIMIN DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL SHQIPTAR (ATP)
(FAZA II 1 KORRIK 2009 - 30 QERSHOR 2011)
NJË PROJEKT BILATERAL BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet të dy vendeve;
në vijim dhe zbatim të marrëveshjes kuadër në lidhje me bashkëpunimin teknik dhe financiar dhe ndihmën humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë së Shqipërisë të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.9801, datë 13 shtator 2007;

duke respektuar parimet demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut siç parashikohen veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut që frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy palëve dhe që përbën një element thelbësor të barasvlefshëm me objektivat e kësaj marrëveshjeje,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane kanë rënë dakord për termat dhe kushtet siç parashikohen më poshtë:

Neni 1

Kushte dhe përkufizime të përgjithshme

Kur përdoren në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Palët kontraktuese” janë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane;

b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” është Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

c) “Projekt” është programi mbështetës i arsimit dhe trajnimit profesional shqiptar;

d) “Ministria” është Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

e) “SDC” është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës;

f) “Grand” është kontributi i dhënë nga Qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;

g) “Swisscontact” është organizata zvicerane zbatuese.

Neni 2

Përgjegjësia e zbatimit

Autoritetet e mëposhtme janë zbatuese për zbatimin e marrëveshjes:

Për Qeverinë Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga zyra e Bashkëpunimit në Tiranë, Ambasada e Zvicrës,

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta janë dy homologët qeveritarë të projektit.

SDC ngarkon Swisscontact me zbatimin e projektit.

Neni 3

Qëllime dhe objektiva

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është mbështetja e sistemit arsimor dhe të trajnimit profesional shqiptar për t'u lidhur dhe përshtatur me kërkesat e tregut të punës, tërheqja e pjesëmarrësve, përpjekja drejt standardeve europiane dhe në këtë mënyrë kontribuimi për zhvillimi ekonomik dhe zbutjen e varfërisë.

Projekti përfshin gjashtë sfera madhore të ndërhyrjeve tek objektivat kryesorë, si më poshtë:

1. Zhvillimi i përjasjeve të përshtatshme trajnuese në arsimin profesional dhe mbështetja e zbatimit të tyre në dy kualifikime të zgjedhura (një prej tyre është instalimi i sistemeve hidraulike) dhe sigurimi i modeleve të organizimit për shkollat multifunkionale për të shërbyer si praktikë e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve.

2. Ngritja dhe inkurajimi i një minimumi prej dy modeleve përkatëse dhe funksionale për partneritet publik-privat për të nxënë (PAFL) duke zhvilluar një mjedis nxitës për bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe dhënësit e trajnimit për dhënien e arsimit dhe trajnimit profesional.

3. Mbështetja e pilotimit të menaxhimit të decentralizuar të arsimit dhe trajnimit profesional të larmishëm dhe fleksibël me financim nga shumë burime në të paktën një qark.

4. Zhvillimi i kapaciteteve të dhënësve publikë dhe privatë të trajnimit për të zhvilluar dhe zbatuar programe të përshtatshme për grupet e veçanta në nevojë, për të tërhequr burimet e nevojshme dhe lehtësuar mundësinë e pjesëmarrjes.

5. Kontributi për zhvillimin e sistemeve të mëtejshme në sferat kryesore të politikës duke përdorur mësimet e nxëna nga përbërësit operacionalë, shkëmbimi rajonal dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

6. Përfitimi nga sinergjia me programe të ngjashme në Kosovë dhe rajon, dhe intensifikimi i shkëmbimit me iniciativën e reformës në arsim në iniciativën e Europës Juglindore.

Objektivat kryesorë specifikohen në dokumentin e projektit, të datës 23 qershor 2009, që është pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Objekti dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

Në pajtim me objektivat kryesorë, marrëveshja mbulon periudhën kohore nga 1 korrik 2009 deri në 30 qershor 2011. Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

1. Shkollat profesionale në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë, Fier, Shkodër për zbatimin e përjasjeve të rishikuara të trajnimit në arsimin profesional.

2. Shoqatat e anëtarësisë së biznesit dhe dhënësit publikë dhe privatë të trajnimit për zbatimin e partneriteteve për të nxënit në Sarandë, Fier, Durrës.

3. Autoritetet rajonale të qarkut Durrës.

4. Agjencia Kombëtare AFP.

5. Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

6. Projektet, organizatat lokale dhe dhënësit e shërbimeve në Berat.

Neni 5

Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Detyrimet specifike të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Qeveria Zvicerane ofron një grand prej 2 600 000 franga zvicerane që përdoret vetëm për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përkufizuara në nenin 3.

b) Ky grand nuk mund të caktohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grandit që mbetet në fund të projektit, duhet t'i shlyhet Qeverisë Zvicerane.

c) Qeveria Zvicerane nëpërmjet SDC-së kontraktton Swisscontact si organizatë zbatuese.

d) Grandi disbursohet dhe auditohet në pajtim me dispozitat e kontratës ndërmjet SDC-së dhe Swisscontact-it.

2. Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës përfundon memorandume mirëkuptimi operacional të veçanta për zbatimin e komponentëve individualë me agjencinë zbatuese;

b) Ministria e Arsimit dhe Shkencës aprovon programin bazë;

c) Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr masat e nevojshme për shkollat profesionale për të prokuruar materialet e nevojshme dhe mallrat për zbatimin e projekteve të të nxënit në bazë të rregullave të prokurimit të Qeverisë Shqiptare;

d) Ministria e Arsimit dhe Shkencës ofron ambientet e zyrave që i jepen Agjencisë Kombëtare VET për Koordinatorin Ndërkombëtar të Programit;

e) Ministria e Arsimit dhe Shkencës ofron burimet e nevojshme njerëzore për të marrë pjesë në masat për ngritjen e kapaciteteve të zbatuara nga projekti për arritjen e objektivave;

f) Ministria e Arsimit dhe Shkencës parashikon buxhetin për rimbursimin e TVSH-së për projektin sipas rastit;

g) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme sheh mundësitë për të marrë pjesë në partneritete për të nxënit, në çfarëdo funksion të përshtatshëm;

h) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme aprovon kurset dhe programet për partneritet për të nxënit;

i) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme, sheh mundësitë për mbështetjen e trajnimit për grupet me nevoja specifike.

Neni 6

Menaxhimi i projektit

1. Projekti është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe SDC-së.

2. Qeveria Zvicerane ka emëruar Swisscontact si agjencinë zbatuese për projektin, sipas një kontrate të nënshkruar ndërmjet Qeverisë Zvicerane dhe Swisscontact. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër në emër të Qeverisë Zvicerane të gjitha detyrat operationale, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin.

3. SDC-ja mund të autorizojë ekspertë të huaj dhe vendas afatshkurtër dhe afatgjatë për të mbështetur zbatimin e projektit, bazuar në konsultime me palët nënshkruese të marrëveshjes,

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. SDC-ja mund të autorizojë individë të tjerë dhe organizata lokale dhe ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të caktuara të projektit, bazuar në konsultime me palët nënshkruese të marrëveshjes, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të projektit të miratuar; merr pjesë në Komisionin e Rishikimit të Projektit/PRC – Komitetin Drejtues/SC; mundëson informacionin përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e projektit. Çdo përdorim tjetër paraqitet për pëlqimin paraprak të Ministrisë.

Neni 7

Mbikëqyrja dhe bashkërendimi

1. Me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja e përgjithshme dhe bashkërendimi i projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, ngrihet një Komision i Rishikimit të Projecktit/KRP/KD – Komitet Drejtues/SC dhe takimet mbahen dy herë në vit (normalisht në qershor dhe nëntor). KRP/KD-ja e ka kuorumin e nevojshëm kur janë të pranishëm përfaqësuesit e të dy palëve kontraktuese dhe vendimet merren me konsensus.

2. KRP/KD-ja përbëhet nga institucionet e mëposhtme me një votë secili:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës (zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe/ose drejtori i politikave parauniversitare të ministrisë);

b) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (zëvendësministri ose drejtori i politikave të punësimit të ministrisë);

c) Agjencia Kombëtare VET (drejtori);

d) Trajnimi Profesional i Shërbimit Kombëtar të Punësimit (drejtori);

e) SDC/zyra zvicerane e bashkëpunimit (drejtori i vendit dhe/ose përgjegjësi i programit).

Sekretariati i komisionit sigurohet nga projekti AlbVET. Koordinatorin ndërkombëtar i programit dhe menaxherin kombëtar të projektit janë të pranishëm në mbledhje pa të drejtë vote.

3. KRP-KD-ja kryen detyrat e mëposhtme:

a) Mbështet projektin dhe jep orientime në gjetjen e zgjidhjeve për problemet e rëndësishme të zbatimit;

b) Miraton planin e aktiviteteve të projektit (plani vjetor i operacioneve/YPO) i paraqitur zyrës së bashkëpunimit zviceran;

c) Rishikon rregullisht arritjet e projektit dhe merr dhe miraton raportet e progresit të projektit;

d) Diskuton dhe shkëmben informacion mbi politikën dhe çështje të tjera.

4. Mbledhjet e paplanifikuara mund të thirren me kërkesë të një prej anëtarëve të PRC-SC-së. Mbledhjet bashkëkryesohen nga palët kontraktuese.

5. Palët kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe, në masën që është praktike normalisht, konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me çdo ngjarje, që ndikon ose rrezikon të ndikojë negativisht te zbatimi i suksesshëm i projektit.

Neni 8

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

1. Mallrat dhe shërbimet që financohen nga shumatat e kontributit zviceran prokurohen në pajtim me rregullat e SDC-së.

2. Për kohëzgjatjen e projektit, mallrat e siguruar me fondet e SDC-së për përdorim në projekt mbeten në disponim të pakufizuar të projektit dhe nuk devijohen nga projekti pa aprovimin paraprak me shkrim të zyrës së bashkëpunimit zviceran.

3. Nëse për një arsye projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të siguruara me kontributin zviceran vendost me shkrim nga palët. Në këtë rast, SDC-ja nuk merr përgjegjësi në lidhje me këto mallra.

4. Në fund të projektit, të dyja palët bien dakord me shkrim për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar gjatë 1 korrikut 2009 deri 30 qershor 2011, periudha e zbatimit të projektit.

5. Mallrat e prokuruar nga projekti për organizatat partnere dhe shkollat dorëzohen dhe merren në dorëzim nga autoriteti përkatës kompetent me aprovimin e përfaqësisë së Qeverisë Zvicerane.

Neni 9

Klauzola antikorrupsion

Palët kontraktuese kanë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit që kërcënon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin. Kështu, ato marrin përsipër të bashkojnë forcat në luftën kundër korrupsionit dhe, veçanërisht, deklarojnë që çdo ofrim, dhuratë, pagesë, shpërblim ose përfitim i çdo lloji që bëhet për këdo, drejtpërdrejt ose jo, me qëllim që të marrin këtë marrëveshje, ose gjatë zbatimit të saj, do të interpretohet si vepër penale ose praktike korruptive. Çdo veprim i këtij lloji përbën shkak të mjaftueshëm për të justifikuar anulimin e kësaj marrëveshjeje, prokurimin ose dhënien e arritur, ose për të marrë çdo masë tjetër korrigjuese që parashikohet nga ligji i zbatueshëm.

Neni 10

Prishja e marrëveshjes

1. Secila palë ka të drejtën ta prishë këtë marrëveshje duke bërë një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara prishjes.

2. Nëse një palë konsideron që qëllimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të arrihen ose që pala tjetër nuk i përmbush detyrimet e saj, ajo palë ka të drejtën të pezullojë ose prishë këtë marrëveshje duke bërë një njoftim me shkrim paraprakisht tre muaj para pezullimit. Pavarësisht nga sa më sipër, një palë mund ta prishë këtë marrëveshje me efekt të menjëhershme në rastin e shkeljes thelbësore të marrëveshjes. Shkelje thelbësore është shkelje serioze e një prej objektivave thelbësore të kësaj marrëveshjeje.

3. Nëse ngjarje që rrjedhin nga forca madhore (fatkeqësi natyrore etj.) parandalojnë ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, secila palë mund ta prishë marrëveshjen me efekt nga momenti kur bëhet e mundur për ta zbatuar atë.

4. Në rastin e prishjes së parakohshme të kësaj marrëveshjeje ose në fund të projektit, çdo fond i pashpenzuar i dhënë në kuadrin e projektit i kthehet SDC-së.

Neni 11

Modifikimet dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me mjetet e bisedimeve diplomatike ndërmjet palëve.

Neni 12

Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, palët nuk propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë përfitime të çdo natyre. Ato nuk pranojnë asnjë nga këto propozime. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme përbën një shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon prishjen e saj dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm.

Bazuar në rezultatin e projektit dhe/ose rezultatin e vlerësimit të përbashkët të jashtëm, të dy palët kontraktuese vendosin nëse dhe në cilën formë do të vazhdojë bashkëpunimi tej qershorit të vitit 2011.

Neni 13
Anekset

Përshkrimi i projektit (aneksi 1) përbën pjesë integrale të marrëveshjes.

Neni 14
Kohëzgjatja dhe fuqia

Kjo marrëveshje mbulon periudhën nga 1 korriku 2009 deri më 30 qershor 2011.

Ajo hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve dhe përfundon sapo të dy palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Kjo marrëveshje shkruhet në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe dhe angleze. Në rastin e dallimeve në interpretim, mbizotëron versioni në anglisht.

Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, bërë në Tiranë më (...)

Në emër të Qeverisë së
Zvicrës
Yvana Enzler
Ambasadore
Ambasada e Zvicrës në
Shqipëri

Në emër të Ministrisë së Arsimit
dhe Shkencës së Republikës së
Shqipërisë
MINISTRI ARSIMIT DHE
SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Në emër të Ministrisë së Punës,
Çështjeve Sociale dhe Shanseve të
Barabarta të Republikës së Shqipërisë
MINISTRI
Spiro Ksera

VENDIM
Nr.283, datë 21.4.2010

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
SË ZVICRËS, PËR EDUKIMIN ALTERNATIV DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL (CEFA),
FAZA E GJASHTË, MAJ 2009 – QERSHOR 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për edukimin alternativ dhe trajnimin profesional (CEFA), faza e gjashtë, maj 2009 – qershor 2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE MBI EDUKIMIN ALTERNATIV DHE
TRAJNIMIN PROFESIONAL (CEFA)

Faza e gjashtë
Maj 2009 – qershor 2012

Një projekt bilateral bashkëpunimi dhe zhvillimi

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane,
në lidhje me lidhjet e miqësisë ndërmjet të dy vendeve,
me dëshirën e forcimit të mëtejshëm të këtyre lidhjeve dhe zhvillimit të një bashkëpunimi
technik të frytshëm,

duke njohur që ekzekutimi i këtij bashkëpunimi teknik do të kontribuojë në përmirësimin e
zhvillimit social dhe edukativ dhe të reformave në sektorin e drejtësisë sociale në Shqipëri,

të ndërgjegjshëm që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i është përkushtuar
ndjekjes së reformave të përgjithshme për të forcuar demokracinë e saj pluraliste,

duke riafirmuar përkushtimin e tyre për demokracinë, të bazuar në shtetin ligjor dhe
respektimin e të drejtave të njeriut,

në pajtim dhe në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin teknik, financiar dhe humanitar, të
nënshkruar më 11 maj, 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.9801, 13 shtator
2007,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë
kuptimet e mëposhtme:

1.1 “Këshilli i Ministrave i Shqipërisë” është Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e
përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

1.2 “Qeveria Zvicerane” është Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të
Jashtme.

1.3 “Grand” është kontributi i dhënë nga Qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje.

1.4 “Palët kontraktuese” janë Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe Qeveria Zvicerane.

1.5 “Ndihmë për fëmijët” (këtu quhet NPF) është organizata zbatuese.

Neni 2
Klauzolë e përgjithshme

Respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave themelore të njeriut sipas parashikimit
në Aktin Final të Helsinkit, në Kartën e Parisit për një Europë të Re dhe Konventën Europiane për
të Drejtat e Njeriut frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy qeverive dhe përbën një
element thelbësor të barasvlershëm me objektivat e mëposhtëm të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3
Objektivat e projektit dhe aktivitetet

3.1 Objektivi i projektit është asistenca për Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Arsimit dhe
Shkencës dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta në fushën e edukimit

të romëve me qëllim që të përforcohet dhe zgjerohet përfshirja sociale e minoritetit rom nëpërmjet arsimit në sistemin arsimor formal, të kontribuojë për të fuqizuar komunitetin e rom dhe të nxisë të drejtat e minoritetit rom.

3.2 Aktivitetet do të mbështeten në shkollat publike të qyteteve të Tiranës, Elbasanit, Korçës dhe Beratit.

3.3 Rezultatet e parashikuara përfshijnë:

- Numri i fëmijëve romë që ndjekin arsimin në shkollat publike mbetet 320 dhe qeveria e pranon qëndrimin e CEFA-s. Nëpërmjet këtij preken 35% e fëmijëve romë në Shqipëri të moshës 10-16 vjeç;

- Trajnimi i trajnuesve në gjuhën rome, që më vonë do të mbajnë kurset e gjuhës rome për fëmijët romë si një aktivitet jashtë programit mësimor.

- Anëtarët e komunitetit rom që përfitojnë nga trajnimi i certifikuar profesional (160) dhe mundësitë e tyre në zgjedhjen e profesionit për trajnimin janë zgjeruar (30 përfitues të trajnuar dhe të pajisur me pajisje profesionale).

- Forcimin e komunitetit rom nëpërmjet pjesëmarrjes dhe vetëveprimit në aktivitetet ekonomike, kulturore dhe sociale dhe vendimmarrjen brenda projektit. Përfaqësuesit e komunitetit rom bëhen pjesë e strukturave vendimmarrëse të CEFA- s dhe në këtë mënyrë kjo përfshirje do të thotë përdorim i mirë i tyre si agjentë ndryshimi.

- Trajnime për të drejtat e njeriut për mësuesit joromë, si dhe për OJQ-të rome dhe anëtarët e komunitetit.

- Trajnim për OJQ-të rome mbi ciklin e menaxhimit të projekteve, zhvillimit organizativ dhe avokatinë për të rritur kapacitetet e tyre për t'u përpjekur për veten e tyre.

Neni 4

Detyrimet e palëve

4.1 Qeveria Zvicerane bie dakord të japë një grand prej deri në CHF 2'220'000 për projektin gjatë kohës së zbatimit në fazën gjashtë (6) nga 1 maj 2009 deri në 30 qershor 2012.

4.2 Ky grand duhet të përdoret ekskluzivisht me qëllim që të arrihen objektivat e sipërpërmendura. Ai nuk mund të alokohet për qëllime të tjera. Çdo pjesë e papërdorur e grandit që mbetet në fund të projektit duhet t'i kthehet Qeverisë Zvicerane. Grandi do të disbursohet në pajtim me dispozitat e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Zvicerane dhe NPF-së.

4.3 Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës kontribuojnë sa më poshtë:

- financimi i tetë mësuesve (një mësues për çdo klasë);

- mbulimi i orëve suplementare për mësuesit që punojnë jashtë orëve të mësimin me fëmijët romë;

- dhënia e trajnimit për mësuesit e klasave CEFA;

- sigurimi i ambienteve në shkolla publike dhe mbulimi i kostos së administrimit të tyre.

4.4 Këshilli i Ministrave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta kontribuon sa më poshtë:

- dhënia e asistencës teknike për familjet rome për t'u regjistruar dhe përfunduar dokumentacionin ligjor që përfshihet në skemat ekzistuese të asistencës ekonomike shtetërore;

- sigurimi i hyrjes dhe dhënies së kurseve arsimore profesionale për njerëzit romë falas në qendrat shtetërore të trajnimit profesional;

- njohja e NPF-së mbi menaxhimin e projektit CEFA si një OJQ që jep shërbime sociale.

Neni 5

Administrimi i grandit

Qeveria Zvicerane ka emëruar NPF-në si agjenci zbatuese për projektin, në pajtim me një kontratë të nënshkruar ndërmjet Qeverisë Zvicerane dhe NPF-së. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër në emër të Qeverisë Zvicerane të gjitha detyrat operacionale, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin.

Neni 6
Mbikëqyrja dhe konsultimet

6.1 Qeveria Zvicerane, Këshilli i Ministrave dhe NPF-ja shkëmbejnë mendime në intervale të rregullta mbi progresin e projektit të financuar sipas kësaj marrëveshjeje. NPF-ja u jep palëve kontraktuese të gjithë informacionin e duhur në lidhje me projektin në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Qeverisë Zvicerane dhe NPF-së.

6.2 Këshilli i Ministrave bie dakord që Qeveria Zvicerane, NPF-ja ose konsulentët e tyre mund të ndërmarrin në çdo moment vlerësime të projektit.

6.3 Palët kontraktuese bien dakord të ngrenë një komitet drejtues për projektin. Komiteti drejtues përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga palët kontraktuese: (i) drejtori i vendit të zyrës së bashkëpunimit SDC në Tiranë, (ii) një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, (iii) një përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, (iv) dy përfaqësues të organizatave rome dhe një drejtor shkolle. Ai mblidhet dy herë në vit.

6.4 Palët kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe, në masën që është praktike në mënyrë të arsyeshme, të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo ngjarje që ndërhyt ose kërcënon me zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7
Klauzola antikorrupsion

Palët kontraktuese kanë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit që kërcënon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin. Kështu, ato marrin përsipër të bashkëpunojnë forcat në luftën kundër korrupsionit dhe, veçanërisht, deklarojnë që çdo ofrim, dhuratë, pagesë, shpërblim ose përfitim i çdo lloji që bëhet për këdo, drejtpërdrejt ose jo, me qëllim që të marrin këtë marrëveshje, ose gjatë zbatimit të saj, do të interpretohet si vepër penale ose praktike korruptive. Çdo veprim i këtij lloji përbën shkaqe të mjaftueshme për të justifikuar anulimin e kësaj marrëveshjeje, prokurimin ose dhënien e arritur, ose për të marrë çdo masë tjetër korrigjuese që parashikohet nga ligji i zbatueshëm.

Neni 8
Pezullimi, prishja

8.1 Në rastin e qënies në vonesë të një prej palëve kontraktuese në përmbushje të një mase apo përkushtimi sipas kësaj marrëveshjeje, pala tjetër kontraktuese mund të bëjë njoftim për pezullimin e kësaj marrëveshjeje.

8.2 Nëse shkak i pezullimit vazhdon tej 90 ditëve, kjo palë kontraktuese mund ta prishë marrëveshjen pa asnjë vonesë tjetër.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të duhet të zgjidhen me mjetet e bisedimeve diplomatike.

Neni 10
Autoritetet

Autoritetet e mëposhtme do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes:

Për Qeverinë Zvicerane:

Agjencia Zvicerane e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit (SDC) e përfaqësuar nga zyra e bashkëpunimit në Tiranë, ambasada e Zvicrës.

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Neni 11
Ndryshimet e marrëveshjes

Ndryshimet e Marrëveshjes realizohen ekskluzivisht nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet palëve kontraktuese.

Neni 12
Hyrja në fuqi, data e mbylljes dhe zgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Ajo mbulon periudhën nga data 1 maj 2009 deri më 31 dhjetor 2012. Ajo mbetet e vlefshme derisa palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre reciproke.

Bërë në Tiranë, më2010, në dy kopje origjinale të gjuhëve angleze dhe shqipe, ku të dy tekstet janë njëjloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim ndërmjet gjuhëve angleze dhe shqipe, mbizotëron versioni në anglisht.

Në emër të Qeverisë së Zvicrës:
Yvana Enzier
Ambasador
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Në emër të Këshillit të Ministrave
të Shqipërisë:
MINISTËR I ARSIMIT DHE
SHKENCËS
Z. Myqerem Tafaj

MINISTRI I PUNËS
ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

VENDIM
Nr.284, datë 21.4.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN
E INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE NË ATË TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në inxhinieri elektrike, me tre drejtime:

a) Elektroteknikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroteknikë.

b) Automatizimi i industrisë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim automatizimi i industrisë.

c) Elektroenergjetikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroenergjetikë.

2. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi.

a) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi, lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në gjeodezi.

3. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë si më poshtë vijon:

- Inxhinieri elektrike, me drejtimet:

a)	Elektroteknikë	12 kuota;
b)	Automatizim i Industrisë	12 kuota;
c)	Elektroenergjetikë	12 kuota;

- Gjeodezi..... 12 kuota.

6. Nga kuotat e mësipërme caktohet 10 për qind për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakultetet përkatëse.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.285, datë 28.4.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË HISTORI, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në histori, me këto drejtime:

a) Histori, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori”.

b) Arkeologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor(Dr.) në histori, me drejtim arkeologji”.

c) Marrëdhënie ndërkombëtare, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori, me drejtim marrëdhënie ndërkombëtare”.

ç) Trashëgimi kulturore, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori, me drejtim trashëgimi kulturore”.

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
3. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 (tre) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2009-2010, është si më poshtë vijon:

a) Histori	30 kuota;
b) Arkeologji	15 kuota;
c) Marrëdhënie ndërkombëtare	30 kuota;
ç) Trashëgimi kulturore	15 kuota.

5. Nga kuota e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, për këto programe studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.286, datë 28.4.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË GJEOGRAFI, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeografi.
2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në gjeografi”.
3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 (tre) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 30.
6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 8. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës.
 9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.287, datë 28.4.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “KRISTAL”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në shkollën e lartë private “Kristal”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) E drejtë publike;
- b) E drejtë penale;
- c) Financë.

2. Këto programe studimi të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)” në:

- a) E drejtë publike;
- b) E drejtë penale;
- c) Financë.

3. Hapjen në shkollën e lartë private “Kristal”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë (MND)”, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Studime europiane”.

4. Ky program studimi i ciklit të tretë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë (MND) në studime europiane”.

5. Shkolla e lartë private “Kristal” Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.292, datë 28.4.2010

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Kostandin Lefta, prefekt i qarkut të Beratit, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z.Bujar Hoxhaj emërohet prefekt i qarkut të Beratit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.301, datë 13.4.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në shkronjën “a”, pas nënndarjes “I” të pikës 1 të kreut II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, për Autoritetin Kombëtar Rrugor, vlera e kufirit për kontratat e punëve publike të jetë sa dyfishi i vlerës së mësipërme të kufirit të përcaktuar për të gjitha entet e tjera.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.302, datë 28.4.2010

**PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRAGAM-KAM-TROPOJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë bujqësore (pemëtore) dhe kultura, drufrutore, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rragam-Kam-Tropojë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 638 (gjashtëqind e tridhjetë e tetë) m², tokë bujqësore (pemëtore), si dhe kultura bujqësore drufrutore, me çmimet konfirmuar nga ZRKKP-ja, me vlerë 131 428 (njëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekë, si dhe kultura bujqësore, me vlerë 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 230 100 (dyqind e tridhjetë mijë e njëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokën bujqësore (pemëtore) dhe kulturat bujqësore, prej 241 428 (dyqind e dyzet e një mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.5.2010 dhe të përfundojë më 1.8.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MPPT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E NR. TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR “RRAGAM-KAM” TROPOJË

Nr.	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Sip.m ²	Çmimi lekë	Vlera lekë	Vlera për kultura bujqësore dhe dru frutorë	Lloji i pasurisë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Din	Sali	Qeleposhi	3490	747/2	158	206	32548		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
2	Dem	Sali	Qeleposhi	3490	747/3	148	206	30488		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
3	Rrustem	Bajram	Çelaj	3490	747/4	201	206	41406	110000	Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
4	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/1	90	206	18540		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
5	Hysni	Shefqet	Rrustaj	3490	645/2	41	206	8446		Pemëtore	Konfirmuar nga ZRPP
						638		131428	110000		
	Shuma								241428		

VENDIM
Nr.303, datë 28.4.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR NDËRTIMIN ME KONCESION TË TERMINALIT TË KONTEINERËVE, NË PORTIN E DURRËSIT, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “DURRËS KURUM SHIPPING” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1 dhe 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për kryerjen e procedurave ligjore për ndërtimin, me koncesion, të terminalit të konteinerëve në Portin e Durrësit, autoriteti kontraktues është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 10% të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Durrës Kurum Shipping” sh.a.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.304, datë 28.4.2010

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT ËNGJËLL GJONDREKAJ, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në zërin “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të shtetasit Ëngjëll Gjondrekaj, në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË
Nr.2816, datë 11.5.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë, truall dhe objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore Korçë (Dritat e Verdha, kryqëzimi Korçë-Kapshticë)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Të gjithë pronarët e objekteve për të cilët është bërë shënimi në kolonën respektive “Leje ndërtimi”, duhet të aplikojnë pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për t’u kompensuar për efekt shpronësimi sipas masës së kompensimit që figuron në publikim.

Për të gjitha rastet e mësipërme do të rikërkohet konfirmim pranë zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Vlera totale e këtij shpronësimi arrin në shumën prej 70 507 937 (shtatëdhjetë milionë e pesëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT "UNAZA VERIORE KORÇË" (DRITAT E VERDHA -KRYQ. KORÇË-KAPSHITICË)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numuri i Pasurisë	TOKË ARË			TOKË TRUALL			VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKE)	SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)		
Korçë Z.K. 8561													
1	Jorgji	Ligor	Baze	8561	1/287				301	10000	3010000	3010000	Konfirmim nga ZVRPP
2	Pavlina		Nuke	8561	1/399				183	10000	1830000	1830000	Konfirmim nga ZVRPP
3	Pavlina		Nuke	8561	1/396				436	10000	4360000	4360000	Konfirmim nga ZVRPP
4	Klea	Vasillaq	Spiro	8561	11//81				235	10000	2350000	2350000	Konfirmim nga ZVRPP
5	Klea	Vasillaq	Spiro	8561	11//82				555	10000	5550000	5550000	Konfirmim nga ZVRPP
6	Klea	Vasillaq	Spiro	8561	11//619				57	10000	570000	570000	Konfirmim nga ZVRPP
7	Klea		Sevo + Bp.	8561	11//95				280	10000	2800000	2800000	Konfirmim nga ZVRPP
8	Ismail		Venxha	8561	1//289				143	10000	1430000	1430000	Konfirmim nga ZVRPP
9	Sotiraq		Kote	8561	1//290				43	10000	430000	430000	Konfirmim nga ZVRPP
10	Ismail		Venxha	8561	1/659				142	10000	1420000	1420000	Konfirmim nga ZVRPP
Korçë Z.K. 8562													
11	Edmond	Ali	Kodra	8562	6/358				125	10000	1250000	1250000	Konfirmim nga ZVRPP
12	Ismail	Xhevdet	Goca	8562	6/61				55	10000	550000	550000	Konfirmim nga ZVRPP
13	Mihal	Xhafer	Goca	8562	6/62				80	10000	800000	800000	Konfirmim nga ZVRPP
14	Arben	Gurtali	Bregu	8562	6/191				30	10000	300000	300000	Konfirmim nga ZVRPP
15	Luan		Boni + Bp.	8562	6/187				22	10000	220000	220000	Konfirmim nga ZVRPP
16	Vaske	Vangjel	Dedo	8562	6/192				16	10000	160000	160000	Konfirmim nga ZVRPP
17	Vaske	Vangjel	Dedo	8562	6/338				40	10000	400000	400000	Konfirmim nga ZVRPP
18	Luan	Selim	Shehu	8562	6/344				32	10000	320000	320000	Konfirmim nga ZVRPP
19	Sadik	Haki	Brahimllari	8562	6/343				80	10000	800000	800000	Konfirmim nga ZVRPP
20	Vangjel	Dini	Haka	8562	6/336				61	10000	610000	610000	Konfirmim nga ZVRPP
21	Jorgji	Dhori	Tanellari	8562	6/233				93	10000	930000	930000	Konfirmim nga ZVRPP
22	Armira	Izet	Iljazi	8562	6/69				74	10000	740000	740000	Konfirmim nga ZVRPP
23	Qerime		Dapellari + Bp	8562	6/388				114	10000	1140000	1140000	Konfirmim nga ZVRPP
24	Qerime		Dapellari + Bp	8562	6/398				32	10000	320000	320000	Konfirmim nga ZVRPP
25	Eksperant	Beshir	Çizi	8562	6/355				55	10000	550000	550000	Konfirmim nga ZVRPP
26	Jetnor	Sadik	Mullali	8562	6/367				25	10000	250000	250000	Konfirmim nga ZVRPP

27	Edmond	Enver	Baki	8562	6\85				30	10000	300000	300000	Konfirmim nga ZVRPP
28	Muhamet	Hamdi	Çizi	8562	6\354				60	10000	600000	600000	Konfirmim nga ZVRPP
29	Eksperant	Beshir	Çizi	8562	6\353				65	10000	650000	650000	Konfirmim nga ZVRPP
	Fshati Barç Z.K. 1101												
30	Nesti		Zhidro	1101	263/53		279.4		120	2581	309720	309720	Konfirmim nga ZVRPP
31	Thoma	Ruben	Balli	1101	263/26		279.4		180	2581	464580	464580	Konfirmim nga ZVRPP
32	Ramadan		Kallo	1101	263/6	58	279.4	16205.2				16205.2	Konfirmim nga ZVRPP
33	Anesti	Qani	Çallo	1101	263/50	125	279.4	34925				34925	Konfirmim nga ZVRPP
34	Ilia	Spiro	Çiko	1101	263/43	88	279.4	24587.2				24587.2	Konfirmim nga ZVRPP
35	Ilia	Spiro	Çiko	1101	263/45	89	279.4	24866.6				24866.6	Konfirmim nga ZVRPP
36	Sotir		Bandilli	1101	263/42	88	279.4	24587.2				24587.2	Konfirmim nga ZVRPP
37	Hekuran		Mahmut	1101	262/55	110	279.4	30734				30734	Konfirmim nga ZVRPP
38	Hekuran		Mahmut	1101	262/54	26	279.4	7264.4				7264.4	Konfirmim nga ZVRPP
39	Shoqeria "Euro Gaz"			1101	262/56		279.4		90	2581	232290	232290	Konfirmim nga ZVRPP
40	Glajdi		Sili	1101	262/75	63	279.4	17602.2				17602.2	Konfirmim nga ZVRPP
41	Gjergji		Mici	1101	262/74	60	279.4	16764				16764	Konfirmim nga ZVRPP
42	Etem		Demiri	1101	262/8	105	279.4	29337				29337	Konfirmim nga ZVRPP
43	Aurel	Jorgji	Xega	1101	262/47		279.4		325	2581	838825	838825	Konfirmim nga ZVRPP
44	Kristina		Beqirllari	1101	262/59		279.4		105	2581	271005	271005	Konfirmim nga ZVRPP
45	Kristina		Beqirllari	1101	262/58		279.4		115	2581	296815	296815	Konfirmim nga ZVRPP
46	Kristina		Beqirllari	1101	262/57		279.4		87	2581	224547	224547	Konfirmim nga ZVRPP
47	Haki	Ismail	Shuri	1101	220/4	125	279.4	34925				34925	Konfirmim nga ZVRPP
48	Spiro	Ilia	Ciko	1101	220/5	50	279.4	13970				13970	Konfirmim nga ZVRPP
49	Enver		Skuri	1101	220/6	175	279.4	48895				48895	Konfirmim nga ZVRPP
50	Ylli		Shuri	1101	220/2	200	279.4	55880				55880	Konfirmim nga ZVRPP
51	Hekuran		Shkuri	1101	220/1	265	279.4	74041				74041	Konfirmim nga ZVRPP
52	Aleks	Jorgji	Xega	1101	222/12	40	279.4	11176				11176	Konfirmim nga ZVRPP
53	Skender		Çallo	1101	222/11	55	279.4	15367				15367	Konfirmim nga ZVRPP
54	Ismail		Latifi	1101	222/10	75	279.4	20955		2581		20955	Konfirmim nga ZVRPP
55	Shoq. Konstruks. + Bp.			1101	222/17				140	2581	361340	361340	Konfirmim nga ZVRPP
56	Thoma	Miha	Çule	1101	222/18				185	2581	477485	477485	Konfirmim nga ZVRPP
57	Guri		Lako	1101	222/13				170	2581	438770	438770	Konfirmim nga ZVRPP
	Edmond		Xhoga										
58	Gezim		Gengo	1101	222/2	105	279.4	29337				29337	Konfirmim nga ZVRPP
59	Gani		Gengo	1101	222/1	125	279.4	34925				34925	Konfirmim nga ZVRPP
60	Thanas		Sulo	1101	204/63				515	2581	1329215	1329215	Konfirmim nga ZVRPP
61	Andri		Çaushti + Bp.	1101	204/24				75	2581	193575	193575	Konfirmim nga ZVRPP
62	Spiro		Temo	1101	204/35				70	2581	180670	180670	Konfirmim nga ZVRPP
63	Arben		Beta	1101	204/65	180	279.4	50292				50292	Konfirmim nga ZVRPP
64	Nuri		Fejzolli	1101	204/49	80	279.4	22352				22352	Konfirmim nga ZVRPP
65	Dhimiter		Lako	1101	204/60	68	279.4	18999.2				18999.2	Konfirmim nga ZVRPP
66	Elton		Fejzolli + Bp.	1101	204/59	11	279.4	3073.4				3073.4	Konfirmim nga ZVRPP

67	Piro		Lupe	1101	204/45	85	279.4	23749				23749	Konfirmim nga ZVRPP
68	Thoma		Piperi	1101	204/42				90	2581	232290	232290	Konfirmim nga ZVRPP
69	Aleks		Foti	1101	204/25	70	279.4	19558				19558	Konfirmim nga ZVRPP
70	Gjergji	Todi	Gjançi	1101	219/8				110	2581	283910	283910	Konfirmim nga ZVRPP
71	Alush		Callo	1101	219/7	170	279.4	47498				47498	Konfirmim nga ZVRPP
72	Llazi		Tasho	1101	219/13	125	279.4	34925				34925	Konfirmim nga ZVRPP
73	Llazi		Tasho	1101	219/16	50	279.4	13970				13970	Konfirmim nga ZVRPP
74	Shoq. "Martinidis" Sh.p.k.			1101	219/35	53	279.4	14808.2				14808.2	Konfirmim nga ZVRPP
75	Ilirjan		Loxe	1101	219/11				205	2581	529105	529105	Konfirmim nga ZVRPP
76	Mevlan		Ploça	1101	219/22	85	279.4	23749				23749	Konfirmim nga ZVRPP
77	Bajram		Mukollari	1101	219/20	80	279.4	22352				22352	Konfirmim nga ZVRPP
78	Arian	Theodhor	Gjançi	1101	219/9	135	279.4	37719				37719	Konfirmim nga ZVRPP
	Gjergji	Theodhor	Gjançi									0	
79	Koli		Lena	1101	218/26	95	279.4	26543				26543	Konfirmim nga ZVRPP
80	Avdulla		Muro	1101	218/2	115	279.4	32131				32131	Konfirmim nga ZVRPP
81	Andrea		Zharanjaku	1101	218/14	100	279.4	27940				27940	Konfirmim nga ZVRPP
82	Leonard		Lico	1101	218/35	35	279.4	9779				9779	Konfirmim nga ZVRPP
83	Agron		Lico	1101	218/5	55	279.4	15367				15367	Konfirmim nga ZVRPP
84	Agron		Lico	1101	218/32	75	279.4	20955				20955	Konfirmim nga ZVRPP
85	Festim		Ravolli	1101	218/7	55	279.4	15367				15367	Konfirmim nga ZVRPP
86	Arjan		Tasho	1101	218/33				62	2581	160022	160022	Konfirmim nga ZVRPP
87	Hekuran		Mahmut	1101	261/55	125	279.4	34925				34925	Konfirmim nga ZVRPP
88	Hamdi		Likollari	1101	261/2	101	279.4	28219.4				28219.4	Konfirmim nga ZVRPP
89	Tefta		Ravolli	1101	261/3	47	279.4	13131.8				13131.8	Konfirmim nga ZVRPP
90	Ombert		Likollari	1101	261/4	140	279.4	39116				39116	Konfirmim nga ZVRPP
91	Skender		Likollari	1101	261/6	80	279.4	22352				22352	Konfirmim nga ZVRPP
92	Mihallaqi		Kapurani	1101	261/42				200	2581	516200	516200	Konfirmim nga ZVRPP
93	Nezir		Ravolli	1101	261/30	31	279.4	8661.4				8661.4	Konfirmim nga ZVRPP
94	Mihallaqis		Thomas	1101	261/69	58	279.4	16205.2				16205.2	Konfirmim nga ZVRPP
95	Sali		Ravolli	1101	261/26	27	279.4	7543.8				7543.8	Konfirmim nga ZVRPP
96	Edi	Niko	Kaco	1101	261/27	145	279.4	40513				40513	Konfirmim nga ZVRPP
	Romeo	Niko	Kaco									0	Konfirmim nga ZVRPP
97	Manoz		Ravolli	1101	261/11	185	279.4	51689				51689	Konfirmim nga ZVRPP
98	Agim		Ravolli	1101	261/67	40	279.4	11176				11176	Konfirmim nga ZVRPP
99	Nuri		Ravolli	1101	261/13	90	279.4	25146				25146	Konfirmim nga ZVRPP
100	Shpetim		Ravolli	1101	261/14	69	279.4	19278.6				19278.6	Konfirmim nga ZVRPP
101	Shpetim		Ravolli	1101	261/65	45	279.4	12573				12573	Konfirmim nga ZVRPP
102	Defrim		Ravolli	1101	261/66	43	279.4	12014.2				12014.2	Konfirmim nga ZVRPP
103	Shpetim		Salihaj	1101	261/58	188	279.4	52527.2				52527.2	Konfirmim nga ZVRPP
104	Ferdinand		Çibuku	1101	261/19	113	279.4	31572.2				31572.2	Konfirmim nga ZVRPP
105	Hysen		Çibuku	1101	261/44	122	279.4	34086.8				34086.8	Konfirmim nga ZVRPP
106	Shoqeria "Elisabet" Sh.p.k.			1101	261/37				115	2581	296815	296815	Konfirmim nga ZVRPP
107	Hymmer		Çibuku	1101	261/21	66	279.4	18440.4				18440.4	Konfirmim nga ZVRPP
108	Artur		Çibuku	1101	261/22	117	279.4	32689.8				32689.8	Konfirmim nga ZVRPP

109	Sulejman		Çibuku	1101	261/23	111	279.4	31013.4				31013.4	Konfirmim nga ZVRPP
110	Nesti	Gjela	Çipi	1101	261/24	50	279.4	13970				13970	Konfirmim nga ZVRPP
	Jani	Kostaq	Roxhe	1101									
111	Jani	Ndina	Roxhe	1101	261/39		279.4		74	2581	190994	190994	Konfirmim nga ZVRPP
112	Gjela		Çipi	1101	261/41		279.4		195	2581	503295	503295	Konfirmim nga ZVRPP
	Kristo		Çipi	1101									
113	Gjela		Çipi	1101	600/1		279.4		28	2581	72268	72268	Konfirmim nga ZVRPP
	Kristo		Çipi	1101									Konfirmim nga ZVRPP
	Fshati Dishnice Z.K. 1491												
114	Lena		Vila + Bp.	1491	593/1		306.8		100	2521	252100	252100	Konfirmim nga ZVRPP
			SHUMA			5742		1604314.8	6820		43295836	44900150.8	

**OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN NË AKSIN RRUGOR "UNAZA VERIORE KORÇË"
(DRITAT E VERDHA-KRYQ. RRUGA KORÇË-KAPSHTICË)**

	PRONARI	Zona kadastrale	Nr. Pasurie	Lloji i objektit	Vlera e llog.lek	Vend ndodhje	Shënime
1	Aurel Xega	1101	262/47	Mur rrethues	379144	Barç,Korçe	Leje ndertimi
2	Gjela Çipi,Kristo Çipi	1101	261/41	Pike karburanti(Total)	5591114	Barç,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
3	Gjela Çipi,Kristo Çipi	1101	600/1	Peshore	1640050	Barç,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
4	Mihallaq Kapurani	1101	261/42	Mur rrethues + objekt	1119436	Barç,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
5	Thanas Sulo	1101	204/63	Pike karburanti(Pjesshem)	4373281	Barç,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
6	Edmond Kodra	8562	6/358	Pike karburanti(Total)	7245780	Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
7	Edmond Baki	8562	6//85	Banese	1921730	Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
8	Jetnor Mullalli	8562	6/367	Banese	1979546	Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
9	Aleks Xega	1101	Ska	Pike karburanti(Pjesshem)	607668	Barç,Korçe	Me leje ndertimi
10	Kristina Beqirllari	1101	262/58,59,60	Pike karburanti(Pjesshem)	360635	Barç,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
11	Lena Vila	1491	593/2	Pike karburanti(Pjesshem)	136731	Dishnice,Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
12	Qerime Dapellari + Bp.	8562	6/396	Objekt	252671	Korçe	Konf. Z.V.R.P.P.Korçe
	TOTALI				25607786		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 24.5.2010

Doli nga shtypi më 26.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë